

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaWrap® FX-50 C

KORDON FIBRASH KARBONI PËR LIDHJE, PËRFORCIM STRUKTUROR DHE ANKORIMIN E SISTEMEVE TË PËRFORCIMIT SIKAWRAP®

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaWrap® FX-50 C është kordon me fibra karboni njëdrejtimëshe, i mbështjellë në kuti plastike që shërben si përforcues i montuar pranë sipërfaqes dhe si lidhës fibrash për ankorimin e pëlhurave SikaWrap®.

PËRDORIMET

SikaWrap® FX-50 C duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

- Ankorim i pëlhurave me fibra karboni ose qelqi SikaWrap® mbi beton ose mur
- Lidhje e pëlhurave me fibra karboni ose qelqi SikaWrap® nëpërmjet strukturave prej betoni ose mureve
- Përforcim fleksibël i montuar pranë sipërfaqes (near surface mounted, NSM)

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Fibër karboni, rezistuese ndaj korrodimit dhe e qëndrueshme
- Shumë përdorime
- Instalim i lehtë

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Ndërtimi	Kordon me fibra karboni njëdrejtimëshe i mbështjellë në zarf plastik	
Lloji i fibrës	fibra karboni	
Ambalazhi	rulon 25 m në shpërndarës plastik	
Jetëgjatësia	24 muaj nga data e prodhimit	
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +35°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor.	
Dendësia e fibrave të thata	1.82 g/cm ³	
Seksioni tërthor	≥ 28 mm ² (bazuar në përmbajtjen e fibrave të karbonit)	
Masa për njësi gjatësie	≥ 50 g/m (përmbajtja e fibrave të karbonit)	
Rezistenca e fibrave të thata ndaj tërheqjes	4 000 N/mm ²	(ASTM D 4018)
Moduli i elasticitetit i fibrave të thata në tërheqje	240 kN/mm ²	(ASTM D 4018)

TË DHËNA TEKNIKE

Prerja tërthore nominale e fletës	78 mm ²	
Rezistenca e fletës ndaj tërheqjes	~2 000 N/mm ² (lidhur me prerjen tërthore të fibrës)*	(EN 2561**)
	*Rrëshira për impregnim: Sikadur®-300, Sikadur®-52 N ose Sikadur®-52 LP *Vlerat në drejtimin gjatësor të fibrave ** Standardi i adaptuar për t'u përshtatur me formën e mostrës	
Moduli i elasticitetit i fletëve në tërheqje	~230 kN/mm ² (lidhur me prerjen tërthore të fibrës)*	(EN 2561**)
	*Rrëshira për impregnim: Sikadur®-300, Sikadur®-52 N ose Sikadur®-52 LP *Vlerat në drejtimin gjatësor të fibrave ** Standardi i adaptuar për t'u përshtatur me formën e mostrës	

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	Ndertimi dhe konfigurimi i sistemit duhet të zbatohet plotësisht siç përshkruhet dhe të mos ndryshohet.	
	Rrëshira për impregnim/ shtrim	Sikadur®-300 ose Sikadur®-52 N ose Sikadur®-52 LP
	Rrëshirë për ankorim	Sikadur®-330 ose Sika AnchorFix®-3+
	Pëlhura e përforcimit strukturor	Pëlhura me fibra karboni ose qelqi SikaWrap®
	Kordoni i ngulitur do të ketë një diameter rreth 10 mm Për informacione të detajuara rreth Sikadur®-330, Sikadur®-300, Sikadur-52 N ose Sikadur®-52 LP dhe AnchorFix®-3+, bashkë me rrëshirën dhe detajet e aplikimit të pëlhurës, ju lutemi referohuni tek skedat teknike dhe Method Statements përkatëse.	

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Konsumimi	Impregnimi i ankorimit: 110–150 g/m Pëlhurat SikaWrap®: Ju lutemi referohuni tek skeda teknike përkatëse
-----------	---

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Rezistenca minimale e nënshtresës ndaj tërheqjes: 1.0 N/mm² ose siç specifikohet në dizajnin e përforcimit. Ju lutemi referohuni tek Method Statement përkatëse për informacione të mëtejshme.

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Betoni duhet të pastrohet dhe të përgatitet për të arritur një sipërfaqe me teksturë të hapur pa kore dhe kontaminime. Ju lutemi referohuni tek Method Statement përkatëse për më shumë informacione.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

SikaWrap® FX-50 C mund të pritët me gërshtë të posaçme. Ju lutemi referohuni tek Method Statement përkatëse për instalimin e SikaWrap® FX dhe procedurën e impregnimit / shtrimit të pëlhurave.

DOKUMENTA SHITESË

Method Statement

Ref. 850 41 09: Instalimi i SikaWrap® FX
Ref. 850 41 02: Aplikim manual i thatë i SikaWrap®
Ref. 850 41 03: Aplikim manual i lagësht SikaWrap®
Ref. 850 41 04: Aplikim i lagësht me makineri SikaWrap®

KUFIZIME

- SikaWrap® FX-50 C duhet të aplikohet vetëm nga profesionistë të trajnuar dhe me përvojë.
- Duhet të këshilloheni me një inxhinier strukturash specialist për çdo përllogaritje të dizajnit të përforcimit.
- Duhet të respektohen dhe kufizimet që përmenden tek Method Statement e instalimit të SikaWrap® FX (Ref. 850 41 09).
- Produktet SikaWrap® janë të veshura për të siguruar ngjitje dhe qëndrueshmëri maksimale me rrëshirat Sikadur® për ngjitje / impregnim / shtrim. Për të ruajtur dhe siguruar kompatibilitetin e plotë të sistemit, mos zëvendësoni përbërësit e ndryshëm të sistemit.
- Sistemi SikaWrap® mund të mbivishet me një veshje

çimentoje ose veshje të tjera për qëllime estetike dhe/ose mbrojtëse. Përzgjedhja e sistemit të mbiveshjes varet nga ekspozimi dhe kërkesat specifike të projektit. Për mbrojtje shtesë nga rrezatimi UV në zona të ekspozuara përdorni Sikagard®-550 W Elastic, Sikagard® ElastoColor-675 W ose Sikagard®-680 S.

- Ju lutemi referohuni tek Method Statement për aplikim të thatë manual të SikaWrap® (Ref. 850 41 02), aplikim të njomë manual të SikaWrap® (Ref. 850 41 03) ose aplikim të njomë me makineri të SikaWrap® (Ref. 850 41 04) për informacione, udhëzime dhe kufizime të mëtejshme.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Ky produkt është një objekt siç përcaktohet në nenin 3 të rregullores (KE) Nr. 1907/2006 (REACH). Nuk përmban substanca që mund të çlirohen nga objekti nën kushte përdorimi normale ose të parashikuara arsyeshëm. Nuk nevojitet fleta e të dhënave të sigurisë në zbatim të nenit 31 të së njëjtës rregulloreje për të sjellë produktin në treg, transportuar apo përdorur atë. Për përdorim të sigurt, ndiqni udhëzimet që jepen në këtë fletë me të dhënat e produktit. Duke u bazuar në njohuritë tona aktuale, ky produkt nuk përmban SVHC (substances of very high concern / substanca me rrezikshmëri të lartë) siç renditen në Aneksin XIV të rregullores REACH apo në listën e substancave kandidatë të publikuar nga Agjencia Europiane e Kimikateve në përqëndrime më të mëdha se 0.2% (për peshë).

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaWrap® FX-50 C

Qershor 2019, Botimi 01.01

020206020040000008

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

SikaWrapFX-50C-sq-AL-(06-2019)-1-1.pdf